



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-68319/23 dt. 31.03.2023, të pronarëve Ymrane Ismajli, Skender, Lirija, Sheriban, Muhamed dhe Taulant Bajrami nga Prishtina dhe investitorit n.p.n “Driloni Com” nga Prishtina, me certifikatë të biznesit me nr. 810707383, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të ndërtesës shumë banesore me afarizëm me etazhitet 2B+P+10, e ndërtuar në bllokun urban b-04 në lagjen “Muhaxhirët” konkretisht në parcelën nr. 10608-0, ZK Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datën 31.10.2023 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit pronarëve Ymrane Ismajli, Skender, Lirija, Sheriban, Muhamed dhe Taulant Bajrami nga Prishtina dhe investitorit n.p.n “Driloni Com” nga Prishtina, me certifikatë të biznesit me nr. 810707383, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-68319/23 dt. 31.03.2023, për përdorimin e ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+10, e ndërtuar në bllokun urban b-04 në lagjen “Muhaxhirët” konkretisht në parcelën nr. 10608-0, ZK Prishtinë, sipas Vendimit 05 Nr.351-122592 dt. 26.09.2013 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr.351-122592 dt. 26.09.2013, dokumentacionit ndërtimor dhe Inspektimit Final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit të Komunës së Prishtinës Sektori i Ndërtimit.

III. Ndërtesa gjindet në rrugën “Jashar Salihu” me numër të hyrjes/daljes 68, 74, 78, 80.

IV. Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

V. Kjo Certificate shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për Mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët Ymrane Ismajli, Skender, Lirija, Sheriban, Muhamed dhe Taulant Bajrami nga Prishtina dhe investitori n.p.n “Driloni Com” nga Prishtina me certifikatë të biznesit me nr. 810707383, me 05 Nr. 391/02-68319/23 dt. 31.03.2023, kanë kërkuar nga kjo drejtori, lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+10, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certificate.

Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare “Njoftim mbi inspektimin final me referencë 09 Nr.391/02-54883/23 dt. 29.03.2023 ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektimit final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit:

- Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f.
- Aktvendimin 05 Nr.351-122592 dt. 26.09.2013 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+10 në parcelën nr. 10608-0, ZK Prishtinë.

- Informim mbi caktimin e adresës nga "Aris" për objektin i cili gjindet në rr. "Jashar Salihu" me numër të hyrjes/daljes 68, 74, 78, 80.
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Robert Gegaj ida - udhëheqës i vendndërtimit, Kushtrim Krasniqi ida - mbikëqyrës për arkitekturë, Bujar Emra idn dhe Blerim Mustafa idn - mbikëqyrës për strukturë, Lavdit Sherifi bsc - mbikëqyrës për hidro-instalime, Agan Elezi ide - mbikëqyrës për instalime elektrike, Bashkim Halabaku idm - mbikëqyrës për instalime makinerike, Shaban Halili - mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania gjeodezike e licencuar "Pro-Gis" me nr. të licencës 10.
- Protokollat e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,
- Çertifikata e pronës dhe kopja e planit

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Njoftimit mbi Inspektimin Final të ndërtimit të ndërtesës i prezentuar nga Drejtorja e Inspektionit Sektori i Ndërtimit, me referencë 09 Nr.391/02-54883/23 dt. 29.03.2023, dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-68319/23 dt. 31.03.2023, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës të fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zeytare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05 Nr.351-122592 dt. 26.09.2013. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore, mund të përdoret.

Në Aktvendimin e Lejes Ndërtimore bashkëpronar janë Enver dhe Agron Bajrami, por gjatë kohës është bërë bartja e trashëgimisë tek Lirija dhe Sheriban Bajrami.

Në Njoftimin mbi inspektimin final të lëshuar nga Drejtorja e Inspektionit-Sektorit i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në ndërtesë janë të përfunduara, dhe se udhëzohet pala që të vazhdojë procedurat për pajisje me certifikatë të përdorimit. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27, janë të aprovuara nga ana e Mbikëqyrjes Profesionale të angazhuar nga ana e Poseduesit të Lejes Ndërtimore.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm, me etazhitet 2B+P+10, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-68319/23 DT. 31.10.2023**

Zyrtari:

Arbër Morina


